



Ekstrakt

Nga procesverbali i mbajtur në takimin e Ekzekutivit të Komunës me qytetarë të Kërpimehut dhe fshatrave përreth, mbajtur më 07 gusht 2019

Takimi filloi në orën 14:05, dhe u mbajt në SHFMU “Hamit Sejdiu” në fshatin Kërpimeh.

Takimin e hapi dhe kryesoi z.Isuf Latifi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Pjesëmarrës nga Ekzekutivi i Komunës ishin; Agim Blakçori, drejtor i drejtorisë së Arsimit, Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Faik Muçiqi drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Vezir Januzi drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Pjesëmarrësit tjerë në këtë takim janë të evidentuar dhe nënshkruar në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë e këtij procesverbali.

Tema: Dëgjim buxhetor rreth përgatitjes së propozim Buxhetit të Komunës për vitin 2020 dhe prioritetet për vitet 2021/2022

Isuf Latifi, drejtor i DBF, e hapi takimin duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, ndër të tjera theksoi, edhe pse ftesat kanë qenë me kohë dhe është pritur dhe dashtë të jetë një numër më i madh i banorëve të këtyre fshatrave, vërehet që pjesëmarrja nuk është e mjaftueshme, por megjithatë ne jemi të obliguar të vazhdojmë me takim.

Sigurisht sikurse për çdo vit, jeni të informuar se gjatë këtyre muajve Komuna zhvillon procesin e përgatitjes së projektbuxhetit për vitin e ardhshëm dhe prioritetet për dy vitet në vijim, e që afati i miratimit është fundi i muajit shtator, buxhet i cili është përcaktuar fillimisht mbi bazën e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020/01 dhe Qarkores Buxhetore 2020/01 të Ministrisë së Financave si dhe projeksionet fillestare të projekteve kapitale, që do të përfshihen në projektbuxhetin e Komunës.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është që qytetarët të paraqesin nevojat dhe prioritetet e investimeve në secilin lokalitet, me qëllim që në planifikimet buxhetore të hyjnë projektet që janë me interes të tyre, natyrisht pas një analize dhe vlerësimi nga ana e Ekzekutivit të Komunës, kjo ngase për propozime, kërkesa, duhet të ketë një arsyeshmëri për shkak që secili projekt duhet t’i përmbush disa kriteret për të qenë i përfshirë në planifikime buxhetore.

Prezent këtu janë edhe disa prej Drejtorëve të Drejtorive të cilët do të evidentojnë kërkesat e juaja, varësisht natyrës së kërkesës, andaj pa humbur kohë, fjala është për Ju të nderuar pjesëmarrës dhe kërkoj që të kontribuoni me propozime dhe kërkesa për investime në projekte konkrete, të cilat do të shqyrtohen nga Ekzekutivi i Komunës.

Faik Kajtazi, përfaqësues i fshatit Pakashicë e Poshtme, paraqiti kërkesat;

-Asfaltimi i rrugës (lagja e epërme në fshat), në gjatësi rreth 200 m, e cila ka qenë në prioritetet nga viti 2010 por që ende nuk është asfaltuar.

-Vazhdimi i ndërtimit të murit mbrojtës në lum.

-Vazhdimi i shtrirjes së kanalizimit edhe në lagjen ku jetojnë rreth 15 familje të cilat nuk janë të lidhura në rrjetin e kanalizimit.

Naim Hoxha, përfaqësues i fshatit Pakashticë e Epërme, paraqiti kërkesat:

-Shtirirjen e rrjetit të kanalizimit, në lagjen Bujaku dhe Aliu, si dhe te familja Hoxha.

-Vendosjen e emrave dhe tabelave të rrugëve.

-Asfaltimin e rrugës që lidhë Pakashticën e Epërme me fshatin Revuçë

-Investime në shkollë, (rregullimi i oborrit, uji, drita etj.)

Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, e njoftoj parafolësin se për shtirirjen e kanalizimit në atë lagje, projekti është në procedurë të prokurimit dhe pritet të përfundoj në këtë vit që jemi.

Isuf Latifi, drejtor i DBF, përgjigje parafolësit, dritat dhe disa çështje tjera që ndërlidhen me shkollën, janë operative, andaj vetëm duhet të kërkohen me kërkesë gjëra të tilla dhe të bëhen furnizimet sepse kemi kontratë për këtë.

Hamdi Jaha, drejtor i DPUMM, përshëndeti të pranishmit, theksoi, ne jemi këtu për të marrë kërkesat dhe prioritet e fshatrave me qëllim që pasi t'i analizojmë të shohim se a munden apo jo të përfshihen në projektbuxhetin e vitit 2020 dhe në prioritetet për 2021/2022, andaj kërkoj që të paraqiten vetëm ato kërkesa që janë më prioritare për banorët e fshatrave përkatëse.

Vezir Januzi, drejtor i DBPZHR, përshëndeti të pranishmit, theksoi, konsideroj se është mirë të paraqiten nevojat prioritare për këto lokalitete. Meqë vij nga kjo anë dhe e njoh këtë terren konsideroj se është e nevojshme që rruga që dërgon në fshatin Metehi të asfaltohet edhe me shtresën e dytë të asfaltit sepse ka një kohë të gjatë që është asfaltuar dhe tani paksa është dëmtuar, pastaj të ketë orinetime në bujqësi si një prej sektorëve kryesor të zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Vlen të theksohet në këto lokalitete është punuar mjaft në shumë fusha, por prioritet ende mbetet uji i pijes, andaj do të ishte mirë të fillohet të ndërmerren hapa që të shtrihet rrjeti i ujësjellësit nga Liqeni i Batllavës.

Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, sa i përket ujit të pijes për këto lokalitete, jemi duke punuar në këtë drejtim, janë duke u bërë hulumtime të ndryshme në disa burime të ujit dhe shumë shpejt pritet të dalim me një rezultat dhe pastaj të fillohet konkretisht.

Mehmet Dibrani, nga fshati Kërpimëh, theksoi, fillimisht shpreh keqardhje për pjesëmarrjen e ulët të banorëve të kësaj ane. Paraqiti kërkesa;

-Asfaltimi dhe shtirirja e kanalizimit në rrugën rreth 150 m gjatësi, e cila gjendet këtu afër (përballë Zyrës së Gjendjes Civile) për të cilën tha se është në gjendje të rënë sidomos kur ka të reshura, janë rreth 17 familje që banojnë aty si dhe është një vajzë me nevoja të veçanta dhe herë pasë here paraqiten problem për bartjen e tij me karrocë.

Pastaj dëshiroj të dijë a është ndërmarrë diçka rreth zgjidhjes së kanalizimit të kësaj ane.

Hamdi Jaha, drejtor i DPUMM, theksoi, ne kemi për obligim të marrim kërkesat e banorëve të këtyre lokaliteteve të cilat pastaj i analizojmë dhe varësisht mundësive buxhetore i përfshijmë në planifikime buxhetore. Unë vazhdimisht kam kërkesa që bëhen drejtpërsëdrejti në zyrën ku punoj, pra pres në takime qytetarët të të gjitha lokaliteteve, andaj edhe po habitem sota paska që nuk ka një pjesëmarrje më të lartë sepse ndoshta për një ditë ka rreth 20-30 qytetarët që vijnë në zyrë dhe paraqesin kërkesa të ndryshme, kurse sot që jemi të obliguar të marrim kërkesat e juaja she të dëgjojmë nevojat e banorëve të kësaj ane, nuk janë prezent.

Konsideroj se është mirë që të paraqiten kërkesa të cila janë në interes të përgjithshëm të banorëve, pra t'iu shmangemi kërkesave që mund të jenë të një interesi personal të ndokujt.

Ne si Drejtori kemi bërë investime të mëdha në këtë rajon, kemi investime edhe në këtë vit dhe natyrisht se do të analizon edhe projekte të ndryshme të cilat do të përfshihen në planifikime buxhetore për 3 vitet e ardhshme.

Sa i përket kanalizimit në këtë rajon të Llapit, në këtë vit do të bëhet projekti nga fshati Pollatë e këndeje, i cili besoj se do të jetë vetëm një gyp kryesor dhe do të ketë zgjidhje afatgjate.

Naim Hoxha, theksoi, sa për sqarim, unë të gjitha kërkesat që i paraqes, paraprakisht konsultohem dhe mbaj takime me të gjithë banorët e lagjeve.

Jakup Gashi, nga fshati Dobërdol, përshëndeti të pranishmit, theksoi, ne do t'i dërgojmë kërkesat dhe prioritetet tona në formë të shkruar dhe do t'iu drejtohem drejtorive përkatëse.

Vezir Januzi, drejtor i DBPZHR, në cilësinë e kryetarit të këshillit të prindërve, paraqiti kërkesën që shkolla e vjetër këtu në Kërpimeh ose të rinovohet ose të rrënohet sepse kështu siç është paraqet rreziqe të ndryshme. Pra t'i bëhet një zgjidhje sepse është domosdoshmëri kjo.

Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, lidhur me atë që parafolësi e tha, mëndmi im është që ai objekt më mirë është të rinovohet dhe të destinohet për qëllime të këtij lokaliteti, qoftë bibliotekë, salla të ndryshëm për aktivitete të ndryshme dhe fusha tjera me rëndësi.

Pra është mirë t'i bëhet një analizë atij objekti.

Qefser Behrami, përshëndeti të pranishmit, dhe paraqiti kërkesat;

-Renovimin e objektit të vjetër të shkollës së Kërpimehut,

-Sigurimi e ujit të pijes në shkollën e kërpimehut dhe ndërrimi i gypave ekzistues sepse janë të vjetruar, edhe pse nesër do të hapet një pus – bunar këtu, por nuk jam optimist që do të bëhet zgjidhje,

-Rregullimi i fushës sportive në shkollën e fshatit Pakashticë e Poshtme,

-Rregullimi i fushës sportive – përfundimi i saj, këtu në afërsi të shkollës së Kërpimehut,

-Shtirirja e rrjetit të kanalizimit në fshatin Metehi, (te lagja e Sabriut dhe lagja Uglari),

-Asfaltimi i rrugëve shumë të vjetra në Metehi, përkatësisht, rruga nga Mulliri, rruga e vjetër rreth 50 m, dhe rruga te Fadili.

Mehmet Dibrani, theksoi, sa i përket shkollës së fshatit Kërpimeh, është e nevojshme të bëhen investime në ujë të pijes dhe tek pullazi.

Agim Blakçori, drejtor i DKA, përshëndeti të pranishmit, theksoi, shkolla e fshatit Kërpimeh është një prej shkollave më të mira, por natyrisht se gjithnjë paraqiten nevojat për intervenime dhe do të ketë intervenime aty ku vlerësohet se është e nevojshme. Objekti i shkollës në fshatin Metehi është fakt se është e vjetruar, mirëpo pritet shumë shpejt ndërtimi i objekti të ri.

Vezir Januzi, në cilësi të banorit të asaj ane, paraqiti kërkesa për asfaltim të rrugëve;

-Rruga tek varrezat e fshatit, në gjatësi rreth 700 m,

-Rruga në lagjen Maksuti,

-Rruga në lagjen Bekteshi,

-Shtirirja e rrjetit të kanalizimit për 7 shtëpi të cila kanë mbete pa u kyçur,

-Intervenim në rrugën që qon në drejtim të Bellosicës, e cila është e nevojshme për punimin e tokave bujqësore.

-Rregullimi i parqeve tek pishat e Pakashticës dhe tek pishat e Kërpimehut,

-Marrja e veprimeve për heqjen – largimin e hekurishtes këtu në Kërpimeh dhe në vend të saj të ndërtohet një stacion për udhëtar.

Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe paraqitjen e kërkesave të tyre sa i përket nevojave të fshatrave të kësaj pjese të Llapit. Qëllimi i takimit ishte të marrim kërkesat e juaj dhe pastaj t'i paraqesim në mbledhje të Ekzekutivit për analizim dhe vlerësim të tyre dhe pastaj të vendosim për të njëjtat.

Takimi përfundoi në orën 15:20

Procesverbalin e mbajti:

Enis Sheholli

Nr.prot.04-400/01-0065571/19

Podujevë,

07 gusht 2019

Drejtori i DBF

Isuf Latifi